

THE ASSETS CONSTITUTING THE COMMUNITY PROPERTY OF SPOUSES UNDER ALBANIAN LEGISLATION AND PROBLEMS OF JUDICIAL PRACTICE

Albana Metaj-Stojanova

Faculty of Law, South East European University, Tetovo, Macedonia, a.metaj@seeu.edu.mk

Abstract: For the first time since the Civil Code of 1929, the Family Code of 2003 recognized the spouses the right to enter into a marriage contract. Thereupon, only in the absence of a contract between spouses for the implementation of another property regime, the legal community regime provided by the provisions of the Family Code will apply. The regime of the legal community implies common property assets, where spouses are inseparable owners, a fact that dictates their inability to freely and independently dispose of the parts belonging to this community. In the absence of a marriage contract, the community property is established automatically with the celebration of marriage. The legal community regime, through equal participation of spouses at 50% on the assets acquired during the marriage, aims at implementing a complete community of life in the property plan as well. The spouse's legal union represents a *sui generis* form of co-ownership, which is subject to a special legal regime and has a special status because it results from the marriage bond. If they are under the community property regime, the spouses, when married, become co-owners of items acquired by one or the other, through different ways of acquiring ownership, provided by the Civil Code. On items earned by each spouse or both together during marriage, they have a right of indivisible property, which gives them the common opportunity to exercise the right of possession, use and disposition of these items. The community property regime establishes the equality of property between the spouses through the realization of the equal sharing of the common objects. Thereby, the lawmaker appreciates and recognizes the contribution made by the spouse who deals with raising and educating the children or maintaining and carrying out the household activity, thus not directly contributing to monetary assets in the common property. The law equates the financial contribution of a spouse to the non-financial contribution of the other spouse, usually the wife, who takes cares of the children and is unemployed. Unlike previous legislation, the current Family Code does not recognize spouses the opportunity to prove they have made a greater contribution and consequently the opportunity to benefit most from the division of common property. The legal community regime has no universal character and it is not mandatory, as spouses can choose another regime, such as the contractor regime. Also in the community property are not included items acquired by spouses before the marriage bond, as well as a category of items obtained during marriage, which preserve their personal character. The composition of the legal community is largely determined by Articles 74 and 77, but also by some other intermediate Articles of the Family Code. From the analysis of these provisions, it is clear that there are: assets immediately entering the community, or the so-called current community (Article 74 / a, 74 / ç); assets that enter into the community only if they remain unconsumed until its end, or the future or eventual community (article 74 / b, 74 / c, 75); wealth that is not part of the community, or community of spouses' personal belongings (Article 77).

Keywords: community property regime, current community, eventual community, personal property of spouses

PASURITË QË PËRBËJNË BASHKËSINË LIGJORE SIPAS LEGJISLACIONIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PROBLEME TË PRAKTIKËS GJYQËSORE

Albana Metaj-Stojanova

Fakulteti Juridik, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, Maqedoni, a.metaj@seeu.edu.mk

Abstrakt: Për herë të parë që nga Kodi Civil i 1929, Kodi i Familjes i vitit 2003, u njeh bashkëshortëve të drejtën për të lidhur kontratë martesore. Për këtë arsye, vetëm në mungesë të një kontrate midis bashkëshortëve për zbatimin e një regjimi tjetër pasuror, do të zbatohet regjimi i bashkësisë ligjore i parashikuar nga dispozitat e Kodit të Familjes. Regjimi i bashkësisë ligjore nënkupton një masë të përbashkët pasurore, ku bashkëshortët janë pronarë të pandarë, fakt ky që dikton dhe pamundësinë e tyre për të disponuar lirisht dhe në mënyrë të pavarur me pjesët që u takojnë nga kjo bashkësi. Në mungesë të kontratës martesore, bashkësia ligjore krijohet automatikisht me celebrimin e martesës. Regjimi i bashkësisë ligjore, nëpërmjet pjesëmarrjes së barabartë të bashkëshortëve në masën 50% mbi pasuritë e fituara gjatë martesës, synon zbatimin e një bashkësie të plotë të jetës edhe në planin pasuror. Bashkësia

ligjore e bashkëshortëve përfaqëson një formë bashkëpronësie *sui generis*, e cila i nënshtrohet një regjimi juridik të posaçëm dhe ka një status special, për arsye se ajo rezulton nga lidhja e martesës. Nëse ndodhen nën regjimin e bashkësisë ligjore, bashkëshortët, gjatë martesës, nëpërmjet mënyrave të ndryshme të fitimit të pronësisë, të parashikuara nga Kodi Civil, bëhen bashkëpronarë të sendeve të fituara prej njërit apo tjetrit. Mbi sendet e fituara nga secili bashkëshort ose nga të dy së bashku gjatë martesës, ata kanë një të drejtë pronësie të pandarë, gjë që u jep mundësinë e përbashkët të ushtrimit të tagrave të posedimit, përdorimit dhe disponimit të këtyre sendeve. Regjimi i bashkësisë ligjore vendos barazi pasurore ndërmjet bashkëshortëve nëpërmjet realizimit të ndarjes së barabartë të sendeve të përbashkëta. Në këtë mënyrë ligjvënësi vlerëson dhe njeh dhe kontributin në natyrë që jep bashkëshorti, i cili merret me rritjen dhe edukimin e fëmijëve apo me mirëmbajtjen dhe kryerjen e veprimtarisë shtëpiake, pra nuk kontribuon drejtpërdrejt me mjete monetare në pasurinë e përbashkët. Ligji barazon kontributin financiar të njërit bashkëshort me kontributin jofinanciar të bashkëshortit tjetër, zakonisht gruaja, që kujdeset për fëmijët dhe nuk është në marrëdhënie pune. Në ndryshim nga legjislacioni paraardhës, KF aktual nuk u njeh bashkëshortëve mundësinë për të provuar se kanë dhënë një kontribut më të madh dhe rrjedhimisht mundësinë për të përfutur pjesë më të madhe nga pjesëtimi i pasurisë së përbashkët. Bashkësia ligjore nuk ka karakter universal. Regjimi i bashkësisë ligjore nuk është i detyrueshëm, pasi bashkëshortët mund të përzgjedhin një regjim tjetër, p.sh. atë kontraktues. Gjithashtu në bashkësi nuk përfshihen sendet e fituara nga bashkëshortët përpara lidhjes së martesës, si dhe një kategori sendesh të fituara gjatë martesës, të cilat e ruajnë karakterin e tyre vetjak. Përbërja e bashkësisë ligjore është përcaktuar kryesisht nga nenet 74 dhe 77, por dhe nga disa nene tjera të ndërmjetme të KF. Nga analiza e këtyre dispozitave, del qartë se ekzistojnë: pasuri të cilat hyjnë menjëherë në bashkësi, apo e ashtuquajtura bashkësia aktuale (neni 74/a, 74/ç); pasuri të cilat hyjnë në bashkësi vetëm nëse mbesin të pakonsumuara deri në mbarimin e saj, apo bashkësia e ardhshme apo eventuale (neni 74/b, 74/c, 75); pasuri që nuk bëjnë pjesë në bashkësi, apo bashkësia e sendeve vetjake të bashkëshortëve (neni 77).

Fjalë kyçe: bashkësi ligjore, bashkësi aktuale, bashkësi eventuale, pasuri vetjake e bashkëshortëve

1. HYRJJE

E gjithë pasuria, e luajtshme dhe e paluajtshme, e fituar nga bashkëshortët, së bashku ose veç e veç, gjatë martesës, me përjashtim të pasurisë vetjake hyn menjëherë, sapo fitohet, në bashkësi dhe konsiderohet si pasuri e bashkësisë. Edhe pasuria e fituar vetëm nga njëri bashkëshort, qoftë edhe pa dijeninë e tjetrit, bën pjesë në bashkësi dhe bashkëshorti tjetër automatikisht konsiderohet pronar *ex lege*. Po ashtu, hyn menjëherë në bashkësi dhe veprimtaria tregtare e krijuar gjatë martesës.²⁸⁴ Pasuria që hyn menjëherë në bashkësi njihet ndryshe si bashkësi aktuale.

Me termin “pasuri e fituar” gjatë martesës kemi parasysh jo vetëm sendet e luajtshme e të paluajtshme, të fituara me titull pronësie apo një të drejtë tjetër reale, por edhe të drejtat e kreditit dhe paditë që mbrojnë këto të drejta, si dhe të mirat jo materiale. Pra, bashkëshortët gjatë martesës mund të fitojnë çdo send apo të drejtë që gjendet në qarkullimin juridiko-civil. Bashkëshorti fiton një pasuri gjatë martesës, nëse ai bëhet titullar i një të drejte reale ose krediti nëpërmjet kryerjes së veprimeve të ndryshme juridike ose në bazë të fakteve juridike. Regjimi juridik i këtyre të drejtave, pra, mënyra e fitimit, ushtrimit, mbrojtjes së tyre rregullohet nga KC.²⁸⁵

2.PASURI QË HYJNË MENJËHERË NË BASHKËSI – BASHKËSIA AKTUALE

Ligji përgjithësisht konsideron që çdo send i fituar gjatë martesës është pjesë e bashkësisë, megjithëse, ka dhe sende të fituara nga njëri bashkëshort gjatë martesës, që konsiderohen si pasuri e tij vetjake. Për të përcaktuar nëse është fituar apo jo ky send, duhet t’i referohemi dispozitave të së drejtës civile. Dy janë mënyrat kryesore të fitimit të pronësisë sipas KC: mënyra origjinale – tituj origjinalë janë fitimi me mirëbesim i sendeve të luajtshme, parashkrimi fitues, fitimi me bashkim e përzjerje, pushtimi, etj. – si dhe mënyra derivative apo e prejardhur – tituj të prejardhur janë kontrata, trashëgimia, etj. Për sa i përket të drejtave reale, sendi i fituar do të bëjë pjesë në bashkësi pavarësisht mënyrës së fitimit, me titull origjinal apo të prejardhur. Për sa i përket të drejtave të kreditit, ato fitohen nëpërmjet: kontratës; fakteve juridike të ligjshme, siç janë gjerimi i punëve të tjetrit, pagimi i pa detyruar dhe begatimi pa shkak²⁸⁶ si dhe nëpërmjet fakteve juridike të paligjshme siç është shkaktimi i dëmit apo dëmi jashtë kontraktues. Sa i

²⁸⁴ Neni 74/a, 74/ç i KF

²⁸⁵ Omari, S., *E Drejtë Familjare*, Tiranë, (2007); Mandro-Balili et al., *E Drejtë Familjare*, Shtëpia Botuese & Shtypshkronja Kristalina KH, Tiranë (2006)

²⁸⁶ Nenet 648-659 të KC

përket momentit të fitimit të sendeve të përbashkëta, ai duhet të jetë pas datës së lidhjes së martesës. Si datë e fitimit do të konsiderohet ajo datë kur njëri nga bashkëshortët do të bëhet titullar i së drejtës së pronësisë ose një të drejte reale tjetër.

Veprimtaria tregtare e krijuar gjatë martesës për herë të parë rregullohet nga KF aktual dhe është rezultat i hapjes së vendit ndaj ekonomisë së tregut dhe promovimit të iniciativës së lirë. Megjithatë, KF nuk përmban shpjegime lidhur me kuptimin, mënyrën e drejtimit e të administrimit të shoqërisë tregtare. Që veprimtaria tregtare të bëjë pjesë në bashkësi është e rëndësishme vetëm koha e krijimit të saj, që kuptohet, duhet të përkohet me një datë mbas lidhjes së martesës.

Elementi kohë (apo data e fitimit të pronësisë) është shumë i rëndësishëm për përcaktimin e përkatësisë së pasurive të fituara nga bashkëshortët. Kështu, nëse pasuria është fituar prej tyre së bashku ose veç e veç, mbas lidhjes së martesës, ajo bën pjesë në bashkësi që nga momenti i fitimit. Po ashtu, edhe veprimtaria tregtare e krijuar mbas lidhjes së martesës, hyn në bashkësi që nga momenti i krijimit. Këto pasuri konsideron të përbashkëta, pasi ligji prezumon se të dy bashkëshortët kanë kontribuar për fitimin e tyre, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, qoftë në mënyrë të tërthortë, nëpërmjet evitimit të shpenzimeve. Kontributi i bashkëshortëve për fitimin e pasurisë së përbashkët prezumohet nga ligji dhe nuk përbën kusht për klasifikimin e pasurisë si pjesë e bashkësisë apo si pasuri vetjake. Pra, elementi kohë është më i rëndësishmi për përcaktimin e pasurive të fituara. Pasuritë e fituara nga bashkëshortët përpara martesës klasifikohen si pasuri vetjake e tyre.

2.1 PASURIA E FITUAR NGA TË DY BASHKËSHORTËT, SË BASHKU OSE VEÇ E VEÇ, GJATË MARTESES

Pasuria e fituar nga bashkëshortët, gjatë martesës hyn në bashkësinë aktuale, pavarësisht nëse është fituar nga të dy së bashku ose individualisht. E rëndësishme është që fituesi i pasurisë të gëzojë cilësinë e bashkëshortit, pasuria të jetë fituar pas lidhjes së martesës dhe të mos klasifikohet si pasuri vetjake nga ligjvënësi. Bashkëshortët, të dy së bashku ose individualisht fitojnë pasuri nga burime të ndryshme ligjore gjatë martesës.

Në literaturën juridike theksohet se sendi do të bëjë pjesë në bashkësi nëse është fituar me burime të ligjshme.²⁸⁷

Kuptohet, që në rastet kur sendi është fituar në mënyrë të paligjshme, si p.sh, sendi është vjedhur, sendi është jashtë qarkullimit juridik apo është fituar në bazë të një kontrate shkak i së cilës është i paligjshëm, do të zbatohen sanksionet civile. Megjithatë, edhe kur veprimi juridik me objekt kalimin e pronësisë është i pavlefshëm, bashkëshortët vazhdojnë të kenë posedimin mbi sendin, pra ekziston bashkësia faktike mbi të. Në këto raste, me rëndësi është fakti nëse bashkëshortët kanë qenë posedues me mirëbesim apo me keqbesim të sendit. Nëse ata kanë qenë me mirëbesim, atëherë u takojnë frutat natyrore dhe civile të sendit²⁸⁸, të cilat bëjnë pjesë në bashkësi. Në kuptim të nenit 151 të KC, frutat natyrore apo civile që fitohen gjatë martesës nga gëzimi i sendeve të përbashkëta janë gjithashtu send i përbashkët, pra pjesë e bashkësisë, përveç rastit kur bashkëshortët kanë rënë dakord që pronësia mbi to t'i kalojë të tjerëve. Nëse frutat civile të një sendi në bashkësi (p.sh. qiraja e një ndërtese të përbashkët) janë vjelë ekskluzivisht nga njëri prej bashkëshortëve dhe të ardhurat nuk janë përdorur në interes të bashkësisë, atëherë ai do të detyrohet t'i kompensojë bashkësisë të ardhurat që ka përdorur për interesin e tij vetjak.

Një mënyrë tjetër e fitimit të së drejtës së pronësisë apo të drejtave të tjera reale nga bashkëshortët është kontrata për tjetërsimin e pasurisë. Pronësia fitohet me anë të kontratës, pa qenë e nevojshme të bëhet dorëzimi i sendit.²⁸⁹ Pra, fitimi i pronësisë nëpërmjet kontratës bëhet nëpërmjet shfaqjes së vullnetit për kalimin e pronësisë, pa qenë e domosdoshme të bëhet dorëzimi i sendit. Në këtë sens, sendi do të konsiderohet i përbashkët, edhe nëse dorëzimi i tij bëhet mbas mbarimit të bashkësisë ligjore.

Në kontratat solemne kalimi i pronësisë në bashkësi do të bëhet vetëm pasi vullneti i palëve të jetë shprehur në formën e kërkuar nga ligji. Pra, nëse kontrata për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme nuk është bërë në formën e aktit notarial dhe regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pronësia mbi sendin nuk ka mundur t'i kalojë bashkësisë. Nuk ka rëndësi nëse në aktin e fitimit figuron emri i njërit bashkëshort, apo i të dyve, mjafton që fituesi i të drejtës të ketë lidhur martesë dhe sendi i kalon direkt bashkësisë. E njëjta vlen dhe për regjistrimin e sendit, ai mund të bëhet në emër të njërit bashkëshort ose të dyve, gjithsesi sendi është pjesë e bashkësisë. Në rastin kur njëri bashkëshort shet një pasuri personale dhe me të ardhurat blen një pasuri të re, ajo do të bëjë pjesë në bashkësi, pasi është blerë gjatë martesës.

²⁸⁷ Begeja, K., *E Drejta Familjare e RPS të Shqipërisë*, Shtypshkronja Mihal Duri, Tiranë, (1984)

²⁸⁸ Neni 297 i KC

²⁸⁹ Neni 164 i KC

Në rastin kur kontrata për fitimin e sendit është me kusht apo me afat, sendi nuk konsiderohet i fituar për sa kohë nuk është vërtetuar kushti apo plotësuar afati. Mirëpo, me vërtetimin e ngjarjes, sendi konsiderohet i fituar nga data e lidhjes së kontratës e jo nga data e vërtetimit të ngjarjes.

Në rastin e shitjes me rezervë të pronësisë, blerësi e fiton pronësinë mbi sendin, jo nga data e lidhjes së kontratës, por nga data kur ka paguar këstin e fundit të çmimit.²⁹⁰ Sipas prof. Bonilinit, në rastet kur fitimi i sendit nuk realizohet nga data e lidhjes së kontratës, por në një datë të mëvonshme, sendi do të përfshihet në bashkësi nëse data kur perfeksionohet e drejta vërtetohet se është gjatë martesës.²⁹¹ Pra, nëse sendi është blerë para martesës nga njëri bashkëshort, por kësti i fundit është paguar gjatë martesës, sendi do të konsiderohet pjesë e bashkësisë ligjore. Në të kundërt, nëse kontrata e shitjes lidhet gjatë martesës, por kësti i fundit i çmimit paguhet pas përfundimit të bashkësisë ligjore, sendi nuk do të konsiderohet i përbashkët.

Në rastin e blerjes së një sendi me kredi, ndryshe nga shitja me rezervë pronësie, kontrata e shitjes është një kontratë e zakonshme, sipas së cilës, pronësia kalon në momentin e lidhjes së kontratës dhe blerësi paguan shumën totale të çmimit. Por, kjo kontratë, shoqërohet nga një kontratë tjetër huamarrjeje, lidhur me një shoqëri bankare apo person fizik. Për të përcaktuar nëse sendi i blerë me kredi është ose jo pjesë e bashkësisë, me rëndësi është data e lidhjes së kontratës së shitjes. Nëse kontrata është lidhur gjatë martesës, sendi i blerë me kredi është i përbashkët, pavarësisht se cili ka marrë pjesë në lidhjen e përbashkët dhe pavarësisht nëse kredia i është dhënë vetëm njërit bashkëshort.

Bashkëshortët mund ta shtojnë bashkësinë edhe me pasuri të fituara gjatë martesës me anë të parashkrimit fitues. Nëse i referohemi neneve 74/a të KF dhe nenit 168 të KC, atëherë çdo pasuri e fituar nga bashkëshortët, gjatë martesës me anë të parashkrimit fitues hyn në bashkësi. Me rëndësi është data e fitimit. Kështu, parashkrimi fitues me titull (neni 168 i KC) është mënyrë për fitimin e sendeve të përbashkëta vetëm nëse veprimi juridik për kalimin e pronësisë (data e titullit), që përbën bazën e parashkrimit është lidhur gjatë martesës. Në të kundërt sendi do të konsiderohet si vetjak, nëse akti i parë i posedimit ka ndodhur përpara lidhjes së martesës, edhe pse afati i parashkrimit plotësohet gjatë martesës. Ndërsa, parashkrimi fitues pa titull (neni 169 i KC) është mënyrë për fitimin e sendeve në bashkësi, nëse data kur ka filluar të rrjedhë afati parashkrues është gjatë martesës, duke pasur parasysh gjithmonë faktin se parashkrimi fitues ka efekt retroaktiv.

Në teorinë juridike mbizotëron mendimi se bëjnë pjesë në bashkësi edhe pasuritë e fituara me parashkrim fitues vetëm nga njëri prej bashkëshortëve, në bazë të posedimit të pandërprerë të sendit. Kështu, sipas prof. Bonilinit, posedimi i sendit për një periudhë të caktuar kohe nga vetëm njëri bashkëshort, do ta bëjë atë pronar mbi sendin me anë të parashkrimit fitues dhe ky përfitim do të konsiderohet se ndodh në favor të dy bashkëshortëve. Ai vlerëson se pasuria e poseduar nga vetëm njëri prej bashkëshortëve duhet të konsiderohet e përbashkët, mjafton që afati ligjor i parashkrimit të përmbillet gjatë kohëzgjatjes së martesës.²⁹²

Mirëpo, posedimi i sendeve vetjake të njërit bashkëshort, nga ana e bashkëshortit tjetër, sado e gjatë të jetë periudha e posedimit, nuk mund të çojë në konkluzionin se këto janë sende të përbashkëta. Kjo, për arsye se ecja e afatit të parashkrimit fitues pezullohet ndërmjet bashkëshortëve.²⁹³ Ligji nuk mund të lejojë që njëri bashkëshort të fitojë me parashkrim fitues pasurinë e bashkëshortit tjetër.

Një problem i diskutueshëm është çështja e përkatësisë së ndërtimeve të realizuara gjatë martesës mbi truallin në pronësi ekskluzive të njërit bashkëshort me të ardhura që bëjnë pjesë në bashkësi ose me të ardhura të bashkëshortit jo pronar të truallit. Lidhur me këtë, mendimi juridik është kontradiktor. Ekzistojnë dy teza kryesore. Sipas së parës, ndërtimi i bërë mbi truallin e njërit bashkëshort përfshihet në bashkësinë ligjore ose më saktë, ndërtesa konsiderohet automatikisht pjesë e bashkësisë, ndërsa trualli mbetet në pronësi të bashkëshortit titullar, i cili fiton të drejtën për tu kompensuar me një shumë të caktuar për humbjen e vlerës së tokës. Teza e kundërt, bazohet në një nga mënyrat me titull origjinal të fitimit të pronësisë, që është bashkimi i një sendi të luajtshëm me një të paluajtshëm (nenet 173-175 të KC). Në këtë bashkim, epërsinë e ka pasuria e paluajtshme dhe çdo e mirë materiale që bashkohet me një send të paluajtshëm i shtohet atij, pra bëhet pronë e pronarit të paluajtshmërisë. Kështu, pronari i tokës do të bëhet dhe pronar i ndërtesës duke fituar me titull origjinal materialet e ndërtimit pronë e tjetrit, të cilat bashkohen me tokën.²⁹⁴

²⁹⁰ Neni 746 i KC

²⁹¹ Bonilini, G., *Manual i së Drejtës Familjare*, Tiranë, (2005)

²⁹² Bonilini, G., *Komentari i së Drejtës Familjare*, Tiranë, (2004)

²⁹³ Neni 129 & 171 i KC

²⁹⁴ Galgano, F., *E Drejta Private 1: Hyrje – Pronësia*, Shtëpia Botuese Luarasi, Tiranë, (2003)

Në këtë kontekst, neni 173 i KC parashikon se mbjelljet, ndërtesat dhe çdo gjë tjetër mbi apo nën sipërfaqen e tokës, i përkasin pronarit të saj. Ndërtimi i realizuar gjatë martesës do të jetë në pronësi ekskluzive të bashkëshortit pronar mbi truallin, ndërkohë që bashkëshortit jo pronar i njihet e drejta për tu kompensuar për shumën vetjake që ka dhënë për ndërtimin. Nëse shumat e shpenzuara për ndërtimin kanë qenë të të dy bashkëshortëve, atëherë do të kompensohet bashkësia.²⁹⁵

Përkatësia e shumave të parave të depozituara gjatë martesës, nga njëri bashkëshort apo të dy së bashku, në ndryshim nga legjislacioni paraardhës, i cili i konsideronte pjesë së bashkësisë, tashmë varet nga prejardhja e shumave të depozituara. Depozitat që i përkasin të dy bashkëshortëve, pra, shuma e të cilave është në bashkësi, do të hyjnë menjëherë në bashkësi, pavarësisht në emër të cilit bashkëshort janë vendosur. Nëse shuma e depozitës bankare të vënë gjatë martesës është pasuri vetjake e njërit bashkëshort, e jo pjesë e bashkësisë, atëherë dhe depozita është pasuri vetjake.

E diskutueshme është dhe përkatësia e sendeve apo shumave të fituara nga njëri bashkëshort nëpërmjet lojërave të fatit. Lidhur me këtë ekzistojnë opinione të ndryshme. Sipas disa autorëve këto fitime përfshihen automatikisht në bashkësi, sipas të tjerëve, ato do të jenë të përbashkëta vetëm nëse nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkësisë. Sipas një tjetër opinioni, çështja zgjidhet në bazë të përkatësisë së shumave të parave që janë luajtur. Pra, shuma apo sendi i fituar do të jetë vetjake, nëse shuma me të cilën është luajtur i përkiste bashkëshortit fitues, ndërsa, kur shuma me të cilën është luajtur është marrë nga bashkësia, fitimi konsiderohet i përbashkët. Kjo zgjidhje duket më e saktë, megjithëse në praktikë do të hasen vështirësi në provimin e përkatësisë së shumës së luajtur.

Lidhur me të drejtën e autorit, çështjet më të diskutueshme kanë të bëjnë sidomos me të ardhurat e fituara nga shpërndarja dhe shfrytëzimi i veprës autoriale. E drejta e shpërndarjes së veprës dhe përcaktimi i kushteve për shfrytëzimin e saj mbeten të drejta vetjake të autorit, por nëse ai vendos ta shpërndajë veprën dhe nga kjo gjenerohen të ardhura, bashkësia duhet të përfitojë, nëse kjo pasuri krijohet gjatë kohëzgjatjes së martesës.²⁹⁶

2.2 VEPRIMTARIA TREGTARE E KRIJUAR GJATË MARTESËS

Veprimtaria tregtare e krijuar gjatë martesës hyn menjëherë në bashkësi (neni 74/ç KF). Sa i përket kësaj veprimtarie, dispozitat e KF duhet të lexohen të kombinuara me legjislacionin që rregullon shoqëritë tregtare e kryesisht me Ligjin nr. 9901 dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i cili parashikon mënyrën e krijimit, formën e një shoqërie tregtare dhe rregullat e administrimit të saj. KF konsideron pjesë të bashkësisë si veprimtarinë tregtare të krijuar gjatë martesës, ashtu dhe fitimet apo shtimin e prodhimit të një veprimtarie të krijuar para martesës. Pra, kriteri që merret për bazë është vetëm koha e krijimit të veprimtarisë dhe detaje të tjera si drejtimi i veprimtarisë nga njëri bashkëshort ose të dy së bashku nuk kanë rëndësi. Veprimtaria tregtare do të konsiderohet e përbashkët, pavarësisht nëse kapitali themelor i shoqërisë përbëhet nga të ardhurat e njërit bashkëshort apo të dyve së bashku. Megjithatë, kapitali themelor duhet të jetë fituar gjatë martesës nga bashkëshortët. Nëse vërtetohet se kapitali themelor përbëhet nga të ardhura të fituara para lidhjes së martesës, atëherë veprimtaria tregtare mund të konsiderohet si pasuri e fituar nga tjetërsimi i pasurisë vetjake (neni 77/dh KF), pra në këtë rast veprimtaria tregtare është pasuri vetjake e bashkëshortit që ka pasur në pronësi që para martesës, mjetet financiare të investuara në kapitalin themelor.²⁹⁷

Nga ana tjetër, blerja apo fitimi i pjesëve ose aksioneve të një shoqërie tregtare gjatë martesës nuk mund të njehsohet me krijimin e një veprimtarie tregtare. Përfshirja ose jo në bashkësi e pjesëmarrjes së njërit bashkëshort në një veprimtari tregtare të themeluar ndërkohë nga të tjerë, varet nga forma e shoqërisë tregtare.²⁹⁸ Kështu, pjesa e fituar nga bashkëshorti në një shoqëri personash, shoqëri kjo që bazohet në cilësitë personale të bashkëthemeluesve dhe parashikon angazhim personal të tyre në administrimin e shoqërisë, nuk mund të bëjë pjesë në bashkësinë ligjore, por do të jetë pasuri vetjake e bashkëshortit që e ka fituar. Nga ana tjetër, aksionet e fituara nga njëri bashkëshort në shoqëritë e kapitalit bëjnë pjesë automatikisht në bashkësinë ligjore, meqenëse cilësitë personale të aksionerit nuk janë të rëndësishme për zhvillimin e veprimtarisë tregtare.

²⁹⁵ Omari, S., *E Drejtë Familjare*, Tiranë, (2007); Mandro-Balili et al., *E Drejta Familjare*, Shtëpia Botuese & Shtypshkronja Kristalina KH, Tiranë (2006)

²⁹⁶ Mandro-Balili et al., *E Drejta Familjare*, Shtëpia Botuese & Shtypshkronja Kristalina KH, Tiranë (2006)

²⁹⁷ Omari, S., *E Drejtë Familjare*, Tiranë, (2007); Mandro-Balili et al., *E Drejta Familjare*, Shtëpia Botuese & Shtypshkronja Kristalina KH, Tiranë (2006)

²⁹⁸ Bonilini, G., *Manual i së Drejtës Familjare*, Tiranë, (2005)

Në një vendim të tij me objekt pjesëtimin gjyqësor të dy shoqërive tregtare mes ish bashkëshortëve, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë shtron çështjen e trajtimit të kapitalit të shoqërisë tregtare si send, gjë në të cilën bazohet dhe parashikimi ligjor i nenit 74/ç të KF për përfshirjen e veprimtarisë tregtare të krijuar gjatë martesës në bashkësi, e për rrjedhojë, pjesëtimin e saj njësoj si sendet e tjera të përbashkëta, në rastin e mbarimit të bashkësisë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë për çështjen në fjalë, vendosi lënien në fuqi të Gjykatës së Apelit, Tiranë dhe lejimin e pjesëtimin të 2 shoqërive tregtare të krijuara gjatë martesës nga ish bashkëshortët sepse në bazë të nenit 74/ç të KF, ato konsiderohen si pjesë e bashkësisë dhe përbëjnë objekt pjesëtimi në rastin e mbarimit të saj. Por, është interesant dhe mendimi kundër i gjyqtarit Ardian Dvorani, i cili bazohet në idenë se shoqëria tregtare, në ndryshim nga sendet, është objekt dhe jo subjekt i së drejtës dhe për këtë arsye ajo nuk mund t'i nënshtrohet pjesëtimin gjyqësor midis bashkëshortëve. Disa nga argumentet që ai jep në favor të tezës së tij janë: së pari, shoqëria tregtare nuk është send, por është një marrëdhënie kontraktuese e natyrës së posaçme, në bazë të së cilës lind e themelohet një person juridik i ri; së dyti, shoqëria tregtare është person juridik, i cili themelohet nga persona fizikë e juridikë, por ka personalitetin e vet juridik në qarkullimin civil si dhe pasuritë e saj (ku përfshihen dhe kuotat e aksionet). Pra, ortakët e një shoqërie tregtare nuk mund të pjesëtojnë gjyqësisht, sipas dispozitave klasike materiale e procedurale civile, kuotat e kapitalit themelor të saj, pasi ato kuota nuk janë në bashkëpronësi të tyre, por janë pronë e shoqërisë. Kuotat e aksionet, pas derdhjes së kontributeve, nuk janë sende (që pjesëtohen), ato në thelb janë një e drejtë pasurore e atij që ka derdhur kontributet. Për më tepër, në bazë të legjislacionit tregtar, për arsye nga më të ndryshmet, përfshirë këtu dhe vullnetin e ortakëve, shoqëria mund të priset, shkrihet ose bashkohet në shoqëri të tjera ose të ndahet në dy a më shumë shoqëri të tjera, por ajo nuk mund të pjesëtohet në rrugë gjyqësore si sendet. Po ashtu, kuotat dhe aksionet që janë pronë e shoqërisë, nuk mund të pjesëtohen gjyqësisht jashtë regjimit normativ të së drejtës tregtare.²⁹⁹

Çështja e ligjshmërisë dhe kushtetueshmërisë së pjesëtimin të këtyre dy shoqërive tregtare, pa pasur si bazë ligjore Ligjin nr.9901, dt.14.04.2008, “Për shoqëritë tregtare” dhe cenimi i personalitetit të personit juridik, u shqyrtua më tej në shqyrtim paraprak dhe nga Gjykata Kushtetuese, me kërkesë të ish bashkëshortit. Gjykata Kushtetuese, lidhur me një nga pretendimet e kërkuarit çmon se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, e kanë argumentuar plotësisht se pse kanë marrë për bazë KC dhe KF në zgjidhjen e konfliktit. Arsyet janë: së pari, pasuria e cila i është nënshtuar pjesëtimin, konsiderohet pasuri e bashkësisë ligjore të çiftit; së dyti KF qëndron më lart në hierarkinë e ligjeve se “Ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, si ligj i miratuar me shumicë të cilësuar; së treti, KF është ligji specifik, i cili rregullon në detaje se çfarë bëhet me pasurinë bashkëshortore pas zgjidhjes së martesës. Në lidhje me pretendimin se gjykimi i pjesëtimin ka cenuar lirinë e ushtrimit të veprimtarisë ekonomike, duke ndërhyrë në ndarjen e kuotave që tashmë ishin të ndara, gjykata çmon se lejimi i pjesëtimin të një pasurie, që përfshin si sende të paluajtshme, ashtu dhe të luajtshme (tituj pronësi – kuotat e shoqërisë), nuk presupozon se personi juridik në vetvete do të priset dhe nuk do të ekzistojë më. Në rastin konkret, kemi dy shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, të cilat janë në pronësi të barabartë të dy palëve ndërgjyqëse dhe është propozuar nga njëra palë, që secili prej tyre të mbajë njërin shoqëri. Pjesëtimi gjyqësor nuk çon në prishje të shoqërive, si persona juridikë, pasi këta të fundit, do të kenë të njëjtat të drejta dhe detyrime si më parë, me ndryshimin se do të jenë me një ortak të vetëm. Në përfundim Kolegji vlerëson se kërkuari nuk i ka provuar pretendimet e tij dhe disa prej tyre nuk i ka ngritur në nivel kushtetues e për rrjedhojë çështja nuk duhet të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.³⁰⁰

Problemet e lidhura me administrimin e shoqërisë tregtare dalin në pah në momentin që kërkohet pjesëtimi gjyqësor i pasurisë. Në një rast që vjen nga praktika gjyqësore e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, paditësja, në padinë e saj përveç pjesëtimin gjyqësor të pasurisë së bashkësisë ligjore, pavarësisht se në emër të kujt ajo figuron e regjistruar, ka kërkuar gjithashtu, anulimin si absolutisht të pavlefshëm të kontratës së shitjes së kuotave të shoqërisë tregtare të krijuar gjatë martesës, me ortak bashkëshortin e saj. I padituri ka transferuar me kundërshtpërbllim, pjesën prej 30% të kuotave që zotëronte në shoqëri, veprim juridik i kryer vetëm disa ditë para se të dorëzohej në gjykatë kërkesa për zgjidhje martesë. Si rrjedhojë, ish bashkëshorti nuk ka më pjesë në këtë shoqëri. Së bashku me anulimin e kontratës së shitjes, paditësja kërkon dhe njohjen e së drejtës së kuotave në shoqërinë tregtare në masën 15%. Gjykatat e faktit të Tiranës, në bazë të analizave të bëra, kanë konstatuar pavlefshmërinë e kontratës së shitjes dhe përfshirjen e kuotave në bashkësinë që do t'i nënshtrohet pjesëtimin. Kjo, për shkak se regjimi pasuror që kishin pasur këta persona gjatë martesës është ai i bashkësisë ligjore, ku prezumohet që të dy bashkëshortët kanë bashkëpronësinë e

²⁹⁹ Vendim Nr.340, dt.26.06.2012 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

³⁰⁰ Vendim i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese të RSH, Nr.22, dt.08.02.2013

çdo pasurie të vënë gjatë martesës, pavarësisht se në emër të cilit është e regjistruar. Në këtë rast, ish bashkëshorti e ka ditur që edhe pse ishte ortak i vetëm i shoqërisë së krijuar gjatë martesës, në momentin e pjesëtimit, ish bashkëshortja do të përfitonte 50% të kuotave të tij në atë shoqëri. Kështu që, pak kohë përpara se të dorëzonte në gjykatë kërkesën për zgjidhje martesë, i ka kaluar me kontratë shitjeje vëllait të tij, kuotat në shoqëri. Ky veprim sipas gjykatave të faktit të Tiranës, është bërë me qëllim që të pakësonte pasurinë që do të përfitonte bashkëshortja pas mbarimit të bashkësisë ligjore.³⁰¹

Veprimtaria tregtare e krijuar para martesës nga njëri prej bashkëshortëve mbetet pasuri vetjake e këtij bashkëshorti edhe gjatë martesës. Nga ana tjetër, sipas nenit 74 të KF, fitimi dhe shtimi i prodhimit të një veprimtarie tregtare të krijuar para lidhjes së martesës do të konsiderohet pjesë e bashkësisë, por vetëm nëse vërtetohet se veprimtaria tregtare drejtohet nga të dy bashkëshortët, pra edhe nga bashkëshorti që nuk ka të drejtë pronësie mbi këtë veprimtari. Kuptimi dhe mënyra apo format e drejtimit të përbashkët mbeten të papërcaktuara e të paqarta. Në të kundërt, nëse vërtetohet se bashkëshorti jo pronar nuk ushtron një aktivitet drejtues në veprimtarinë tregtare të bashkëshortit tjetër, fitimi apo shtimi i prodhimit nuk do të jenë pjesë e bashkësisë aktuale. Në këtë rast, fitimi apo shtimi i prodhimit do të konsiderohen si fruta civile të pasurisë vetjake të bashkëshortit pronar dhe si të tilla, do të bëhen pjesë e bashkësisë ligjore vetëm nëse nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkësisë (neni 74/c KF).

3. PASURI QË HYJNË NË BASHKËSI NË FUND, NËSE MBESIN – BASHKËSIA EVENTUALE

Neni 74 i KF, në germa b) dhe c), dallon edhe pasuri, të cilat nuk hyjnë menjëherë në bashkësi, por që duhet të pjesëtohen mes bashkëshortëve, nëse ekzistojnë, pra nuk janë konsumuar deri në momentin e mbarimit të bashkësisë. Ato janë:

- 1. të ardhurat nga veprimtaria e veçantë e çdo bashkëshorti;
- 2. frytet e mbledhura të pasurisë vetjake të çdo bashkëshorti;
- 3. pasuria e krijuar gjatë martesës, e caktuar për administrimin e veprimtarisë tregtare.

Këto janë të mira që gjatë martesës përbëjnë pasuri vetjake të njërit prej bashkëshortëve, por janë të destinuar për ta humbur këtë karakter ekskluziviteti në momentin e mbarimit të bashkësisë. Pra, sendet e bashkësisë eventuale kanë një natyrë juridike dualiste. Për këtë arsye dhe regjimi i tyre juridik është i ndryshëm nga i sendeve në pronësi të menjëhershme. Sendet e bashkësisë eventuale nuk përfshihen në bashkësi që nga momenti i fitimit, por do të llogariten si pjesë e bashkësisë e do të pjesëtohen midis bashkëshortëve eventualisht, nëse në momentin e mbarimit të bashkësisë janë ende të pa konsumuara. Pra, vetëm nëse në përfundim të bashkësisë ligjore, qoftë për shkak të zgjidhjes së martesës, qoftë për shkak të ndryshimit të regjimit të bashkësisë me marrëveshje të bashkëshortëve, do të konstatohet se këto sende nuk janë konsumuar, por janë ruajtur në formën e kursimeve, vetëm atëherë ato do të konsiderohen si sende të përbashkëta e do të pjesëtohen në pjesë të barabarta midis bashkëshortëve. Në themel të kësaj zgjidhjeje ligjore qëndron prezumimi se edhe bashkëshorti tjetër ka kontribuar në ruajtjen e këtyre të ardhurave. Kuptohet që bashkëshorti tjetër do të përfitojë nga këto kursime vetëm nëse vërtetohet që ato kanë ekzistuar në momentin e mbarimit të bashkësisë, por ekziston mundësia që bashkëshorti që i ka fituar t'i fshehë këto të ardhura me qëllim që ato të mos pjesëtohen. Nga ana tjetër, nëse këto të ardhura nuk ekzistojnë për shkak se janë shpenzuar nga bashkëshorti titullar, bashkëshorti tjetër nuk mund të kërkojë kompensim të bashkësisë për neglizhim të mbledhjes apo shpërdorim nga ana e bashkëshortit titullar, sipas nenit 78 të KF.

Sa i përket mundësive praktike për përdorimin e të ardhurave që bëjnë pjesë në bashkësinë eventuale, ekzistojnë tre destinacione: këto të ardhura mund të konsumohen për nevoja personale ose familjare dhe në këtë rast bashkëshorti tjetër nuk mund të ketë asnjë pretendim, pasi në momentin kur janë shpenzuar nuk kanë qenë pjesë e bashkësisë; të ardhurat mund të shndërrohen në sende dhe në këtë rast duhet parasysh se këto sende do të bëjnë pjesë në bashkësi që nga data e fitimit të tyre; të ardhurat mund të mos konsumohen e të ruhen në formën e kursimeve, që do të jenë objekt i pjesëtimit të ardhshëm, nëse nuk janë shpenzuar deri në zgjidhjen e bashkësisë.³⁰²

3.1 TË ARDHURAT NGA VEPRIMTARIA E VEÇANTË E ÇDO BASHKËSHORTI GJATË MARTESËS, NËSE NUK JANË KONSUMUAR DERI NË MBARIMIN E BASHKËPRONËSISË

Të ardhurat nga veprimtaria e veçantë e çdo bashkëshorti, do të konsiderohen si sende në bashkësi, nëse nuk janë konsumuar deri në përfundim të saj (neni 74/b i KF). Me veprimtari të veçantë të secilit bashkëshort, kuptojmë jo vetëm marrëdhënien e rregullt të punës si aktivitet bazë, por edhe ushtrimin e një veprimtarie pune të pavarur

³⁰¹ Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, Nr.138, dt.13.03.2012

³⁰² Omari, S., *E Drejtë Familjare*, Tiranë, (2007); Bonilini, G., *Manual i së Drejtës Familjare*, Tiranë, (2005)

profesionale apo intelektuale. Si rrjedhojë, të ardhura të tilla janë shpërblimet periodike nga marrëdhënia e punës, por edhe shpërblimet jo periodike si bursat e studimit, të ardhurat nga pronësia intelektuale etj. Shfrytëzimi ekonomik i veprës autoriale apo e drejta materiale e autorit, si dhe çdo dëmshpërblim i përfituar nga autori për përdorimin pa të drejtë të veprës së tij, bën pjesë gjithashtu në bashkësinë eventuale. Përjashtim bën rasti, kur ky fitim nëpërmjet blerjeve konvertohet menjëherë në të mira reale, që hyjnë në bashkësinë aktuale.³⁰³

Që të ardhurat nga pronësia intelektuale të bëjnë pjesë në bashkësinë eventuale, duhet që pagesa efektive e tyre të jetë kryer gjatë martesës, megjithëse krijimi autorial (vepra autoriale apo shpikja) mund të jenë realizuar përpara lidhjes së martesës. Në të kundërt, të ardhurat e fituara mbas martesë, nga një krijim intelektual i realizuar gjatë martesës, konsiderohen si pasuri vetjake.³⁰⁴

Secilit bashkëshort i njihet mundësia, në diskrecion të vet, t'i përdorë të ardhurat vetjake, si p.sh. të ardhurat e fituara nga puna dhe ushtrimi i një profesioni, por gjithmonë, sipas rregullave të regjimit të bashkësisë ligjore. Kjo do të thotë, se secili bashkëshort ka të drejtën t'i përdorë e disponojë sipas pëlqimit këto të ardhura, por vetëm pasi ka kontribuar për detyrimet që rrjedhin nga martesë (neni 54, 63 KF). Detyrimet që rrjedhin nga martesë duhet të përmbushen me përparësi, pavarësisht llojit të regjimit pasuror të përzgjedhur nga bashkëshortët. Pra, liria e disponimit të të ardhurave vetjake realizohet vetëm nëse janë përmbushur detyrimet martesore. Kemi parasysh, se masa e kontributit të bashkëshortëve për detyrimet që rrjedhin nga martesë, nëse nuk është vendosur në kontratën martesore, do të diktohet nga nevoja e familjes, në përputhje me kushtet dhe aftësitë e secilit bashkëshort.³⁰⁵

Sa i përket të ardhurave të depozituara në banka, ato do të llogariten si sende vetjake ose të përbashkëta, varësisht prejardhjes së shumave në momentin kur është bërë depozitimi. Nëse njëri prej bashkëshortëve ka depozituar të ardhura personale në emër të një personi të tretë, p.sh. fëmijës, apo i ka depozituar duke përcaktuar se do të tërhiqen nga një person i caktuar pas vdekjes së tij, atëherë këto të ardhura nuk mund të konsiderohen si të pa konsumuara sepse bashkëshorti titullar i ka disponuar nëpërmjet një veprimit juridik *inter vivos* në rastin e parë dhe *mortis causa* në rastin e dytë.

3.2 FRYTET E Mbledhura të pasurisë vetjake të çdo bashkëshorti, që nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë

Sipas nenit 74/c të KF, frytet e mbledhura të pasurisë vetjake të çdo bashkëshorti që nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë janë pjesë e bashkësisë eventuale. Frytet janë sende që sendi kryesor i jep periodikisht, por që janë të destinuara për ndarje.³⁰⁶ Frytet e sendit, që mund të jenë natyrore ose civile (neni 145 KC), janë fitimet që realizon pronari nga sendi. Frytet natyrore prodhohen në mënyrë të natyrshme, pavarësisht vullnetit të njeriut, ndërsa frytet civile janë pasojë e veprimeve juridike. Frytet civile zakonisht përfaqësojnë të ardhura monetare siç janë: qiraja nga sendet vetjakë, kamatat që rrjedhin nga të ardhurat vetjake, të ardhurat e fitura nga pronësia intelektuale etj. Që frytet mund të mblidhen apo “merren”, në terminologjinë e nenit 74/c të KF, duhet që ato të shkëputen nga sendi. Fryti natyror i shkëputur përbën një send të veçantë, që si i tillë mund të bëjë pjesë në bashkësi nëse në mbarim të saj është i pakonsumuar dhe mblidhet apo “merret”, pra hyn në posedim të bashkëshortit titullar. Ndërsa, për frytet civile shkëputja lidhet me kohën kur ato bëhen të kërkueshme³⁰⁷. Frytet civile do të konsiderohen “të marra”, nëse janë bërë për t'u mbledhur, pavarësisht nëse bashkëshorti titullar i ka marrë apo jo në dorëzim.³⁰⁸

Sa i përket mbulimit të shpenzimeve të nevojshme për mbledhjen e fryteve të sendeve vetjake, KF nuk përcaktohet shprehimisht. Por, në bazë të rregullit të përgjithshëm të së drejtës civile, sipas të cilit kush përfiton nga një veprimtari duhet t'i përmbushë dhe detyrimet e saj (*ubi emolumentum ibi onus*), arrijmë në përfundimin se shpenzimet e bëra për mbledhjen e fryteve nga sendet vetjake, do të kompensohen nga bashkësia, gjithmonë nëse frytet ekzistojnë në momentin e mbarimit të bashkësisë.³⁰⁹

³⁰³ Bonilini, G., *Manual i së Drejtës Familjare*, Tiranë, (2005)

³⁰⁴ Omari, S., *E Drejtë Familjare*, Tiranë, (2007)

³⁰⁵ Mandro, A., *E Drejta Familjare, Familja, Fëmijët, Martesa, Bashkëshortët*, Tiranë, (2009); Omari, S., *E Drejtë Familjare*, Tiranë, (2007)

³⁰⁶ Gams, A., *Bazat e së Drejtës Reale*, Prishtinë, (1976)

³⁰⁷ Neni 145/4 i KC

³⁰⁸ Shehu, A., *Pronësia*, Tiranë, (2000); Aliu, A., *E Drejta Sendore*, Universiteti i Prishtinës, (2014)

³⁰⁹ Omari, S., *E Drejtë Familjare*, Tiranë, (2007)

Ashtu si të ardhurat e realizuara nga veprimtaria e veçantë e çdo bashkëshorti gjatë martesës, dhe frytet e pasurisë vetjake të fituara gjatë martesës, apo për sa kohë zgjat bashkësia, i nënshtrohen një regjimi juridik të dyfishtë. Gjatë ekzistencës së bashkësisë, ato do të konsiderohen si pronësi vetjake dhe bashkëshorti titullar mund t'i përdorë sipas vullnetit të tij, pa marrë pëlqimin e bashkëshortit tjetër, por gjithmonë pasi të ketë përmbushur detyrimet martesore. E nëse frytet e sendeve personale nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkësisë, do të konsiderohen si pasuri e përbashkët.

3.3 PASURIA E KRIJUAR GJATË MARTESËS, E CAKTUAR PËR ADMINISTRIMIN E VEPRIMTARISË TREGTARE

Sipas nenit 75 të KF pasuria e krijuar gjatë martesës, e caktuar për administrimin e veprimtarisë tregtare të njërit bashkëshort si dhe shtesat e prodhimit të saj janë objekt i bashkëpronësisë vetëm nëse ekzistojnë si të tilla në çastin e mbarimit të martesës. Administrimi i shoqërisë tregtare nënkupton kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme për ushtrimin e zakonshëm të veprimtarisë tregtare.³¹⁰ Pra, pasuria e krijuar gjatë martesës, e caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare të njërit bashkëshort, do të fitojë statusin e saj fillestar si pasuri e bashkësisë vetëm nëse ekziston në momentin e mbarimit të martesës.

4. PËRFUNDIME

Legjislacioni shqiptar ofron rregullim të detajuar e bashkëkohor sa i përket institutit të bashkësisë ligjore, ngjashëm me legjislacionet perëndimore, e më konkretisht me atë italian e francez. Me rënien e regjimit komunist legjislacioni shqiptar ndryshoi tërësisht duke ofruar tashmë zgjidhje për situatat e reja të krijuara me njohjen e pronës private dhe dhe zhvillimin e iniciativës së lirë dhe ekonomisë së tregut. Në këtë kontekst, Kodi aktual i Familjes nuk i kufizon bashkëshortët në përzgjedhjen e regjimit pasuror që ata dëshirojnë nëpërmjet lidhjes së kontratës martesore, me anë të së cilës bashkëshortët mund t'i rregullojnë regjimet bashkëshortore sipas interesave dhe kërkesave të tyre specifike.

LITERATURA

- [1] Omari, S., *E Drejtë Familjare*, Tiranë, f. 102-207, 2007
- [2] Mandro-Balili et al., *E Drejta Familjare*, Shtëpia Botuese & Shtypshkronja Kristalina KH, Tiranë, f. 319-341, 2006
- [3] Begeja, K., *E Drejta Familjare e RPS të Shqipërisë*, Shtypshkronja Mihal Duri, Tiranë, f. 145, 1984
- [4] Bonilini, G., *Manual i së Drejtës Familjare*, Tiranë, f. 93-119, 2005
- [5] Bonilini, G., *Komentar i së Drejtës Familjare*, Tiranë, f. 224-235, 2004
- [6] Galgano, F., *E Drejta Private 1: Hyrje – Pronësia*, Shtëpia Botuese Luarasi, Tiranë, f. 165-166, 2003
- [7] Mandro, A., *E Drejta Familjare, Familja, Fëmijët, Martesa, Bashkëshortët*, Tiranë, (2009); Omari, S., *E Drejtë Familjare*, Tiranë, f. 228-229, 2009
- [8] Gams, A., *Bazat e së Drejtës Reale*, Prishtinë, f. 17, 1976
- [9] Shehu, A. *Pronësia*, Tiranë, f. 8, 2000
- [10] Aliu, A., *E Drejta Sendore*, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, f. 54-55, 2014
- [11] Kodi Civil i Përditësuar dhe me Praktikë Gjyqësore, Botime Juridike Alb Juris, Tiranë, (2014)
- [12] Kodi i Familjes i RSH, Ligj nr. 9062, dt. 08.05.2003
- [13] Ligji nr. 9901, dt. 14.04.2008 Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare

³¹⁰ Neni 33/1 i ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

